

# INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT


Maj 2026

Norma e inflacionit e matur me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin Maj 2026 ishte 3,0 për qind, nga 2,2 për qind në Maj 2025.

Krahasuar me muajin Prill 2026, çmimet e konsumit u ulën me 0,04 për qind.


Rritja vjetore e çmimeve në Maj 2026 u ndikua kryesisht nga grupi "Transporti" me 7,8 %, pasuar nga "Sigurime dhe shërbime financiare" me 4,9 %, "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" dhe "Argëtim, sport dhe kulturë" me 4,2 % secili, Pije alkoolike dhe duhan" me 3,4 %, "Restorante dhe shërbime akomodimi" dhe "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me 3,0 % secili, "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 2,8 %, "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 2,2 %, "Shërbimi arsimor" me 2,1 %, "Shëndeti" me 1,6 %, "Informacioni dhe komunikimi" me 0,5 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Veshje dhe këpucë" u ulën me 0,5 %.

**FIG. 1 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT (%)**



Krahasuar me Prill 2026, ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Veshje dhe këpucë" me 0,5 %, pasuar nga grupet "Ushqime dhe pije joalkoolike" dhe "Transporti" me 0,4 % secili. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Argëtim, sport dhe kulturë" u rritën me 1,1 %, pasuar nga grupet "Shëndeti" me 0,9 %, "Pije alkoolike dhe duhan" me 0,7 %, "Sigurime dhe shërbime financiare" me 0,6 %, "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 0,5 %, "Restorante dhe shërbime akomodimi" dhe "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me 0,3 % secili, "Informacioni dhe komunikimi" me 0,1 %.

**FIG. 2 NDIKIMI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR**



**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor**

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Maj është ndikuar kryesisht nga grupi “Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera” me +0,84 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +0,76 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit “Transporti” me +0,51 pikë përqindje, çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me + 0,20 pikë përqindje, çmimet e grupeve “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Restorante dhe shërbime akomodimi” ndikuan me +0,17 pikë përqindje secili, çmimet e grupit “Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme” me +0,13 pikë përqindje, çmimet e grupit “Argëtim, sport dhe kulturë” me +0,09 pikë përqindje, çmimet e grupeve “Shërbimi arsimor” dhe “Sigurime dhe shërbime financiare” me +0,07 pikë përqindje secili, çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,05 pikë përqindje, çmimet e grupit “Informacioni dhe komunikimi” me +0,02 pikë përqindje dhe çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” me -0,02 pikë përqindje.

TAB. 1 INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Kodi	Grupet	Peshat	05-26/Viti 2025	05-26/04-26	05-26/05-25
	<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>102,8</b>	<b>-0,04</b>	<b>3,0</b>
01.	Ushqime dhe pije joalkolike	34,1	102,6	-0,4	2,2
02.	Pije alkolike dhe duhan	5,0	103,1	0,7	3,4
03.	Veshje dhe këpucë	3,8	99,2	-0,5	-0,5
04.	Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera	20,2	103,0	0,0	4,2
05.	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,0	102,6	0,5	2,8
06.	Shëndeti	3,2	101,6	0,9	1,6
07.	Transporti	6,4	107,8	-0,4	7,8
08.	Informacioni dhe komunikimi	3,6	100,5	0,1	0,5
09.	Argëtim, sport dhe kulturë	2,0	104,3	1,1	4,2
10.	Shërbimi arsimor	3,0	101,4	0,0	2,1
11.	Restorante dhe shërbime akomodimi	5,7	102,3	0,3	3,0
12.	Sigurime dhe shërbime financiare	1,5	105,0	0,6	4,9
13.	Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme	4,5	102,5	0,3	3,0

**Shënim për përdoruesit:**

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Indeksi i Çmimeve të Konsumit](https://www.instat.gov.al/)

# Metodologjia

## Ndryshime metodologjike

Duke filluar nga Shkurt 2026, Indeksi i Çmimeve të Konsumit përlogaritet sipas klasifikimit ECOICOP 2018. Kalimi në klasifikimin e ri përfshin ristrukturimin e artikujve të shportës, riklasifikimin e disa produkteve. Struktura e ECOICOP ver. 2 përbëhet nga 13 divizione kryesore, të detajuara më tej në grupe, klasa dhe nënklasa. Implementimi i këtij klasifikimi është në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/3159, duke siguruar harmonizimin e plotë me praktikat statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.

Periudha e referencës së indeksit është ndryshuar nga Dhjetor 2020 = 100 në 2025 = 100.

Gjithashtu, në muajin Janar si çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2024.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga **411** produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

## Përkufizime

**Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)** është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

**Ndryshimi mujor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

**Ndryshimi mesatar 12 mujor** mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.